



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**PSH. nr. 60/23**  
**62/23**

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi Kryetar, Agon Ramadani- Anëtar si dhe Kimete Gashi- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga ankuesi "Kelmend Kastrati" nga Prishtina si dhe aneksen e "Anitë Sadikaj" nga Prishtina, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Angazhimi i 5 eksperteve për punë dhe detyrë specifike, menaxhim të kontratave për nevojat e Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit: 616-22-9087-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me datën 20.04.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

- Aprovohen**, si të bazuara ankesat e parashtruar nga ankuesi "Kelmend Kastrati" nga Prishtina me datë 02.02.2023 (me numër protokoll 60/2023) si dhe ankesën e "Anitë Sadikaj" nga Prishtina e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 05.02.2023 (me numër protokoll 62/2023) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Angazhimi i 5 eksperteve për punë dhe detyrë specifike, menaxhim të kontratave për nevojat e Komunës së Prishtinës.
- Anulohet**, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 17.01.2023, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Angazhimi i 5 eksperteve për punë dhe detyrë specifike, menaxhim të kontratave për nevojat e Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit: 616-22-9087-2-1-1, iniciuar nga AK- Komuna e Prishtinës, ndërkaq aktiviteti i prokurimit i lartë përmendur kthehet në **rivlerësim**.
- Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj Panelin Shqyrtues të OSHP, për gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi. Në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar).

4. Me qenë se ankesat e parashtruara nga ankuesi “Kelmend Kastrati” nga Prishtina si dhe ankuesja “Anitë Sadikaj” nga Prishtina aprovohen, pjesërisht si të bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

5. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **A r s y e t i m**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 17.01.2023, Kuvendi Komunal Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B58 Njoftimin për Kontratë për aktivitetit të prokurimit me titull: “Angazhimi i 5 eksperteve për punë dhe detyrë specifike, menaxhim të kontratave për nevojat e Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit: 616-22-9087-2-1-1.

Me datë 20.01.2023, ankuesi “Kelmend Kastrati” nga Prishtina ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Kuvendi Komunal Prishtinës, me datë 23.01.2023 AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 17.01.2023.

Me datë 23.01.2023, ankuesja “Anitë Sadikaj” nga Prishtina ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Kuvendi Komunal Prishtinës, me datë 26.01.2023 AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 17.01.2023

Me datën 02.02.2023 ankuesi “Kelmend Kastrati” nga Prishtina, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 60/2023, kundër B58 Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër. Po ashtu i pa kënaqur me vendimin e AK me datë 05.02.2023 ankuesja “Anitë Sadikaj” nga Prishtina, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 62/2023, kundër B58 Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 216,000 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 10 mars 2023 me raportin e ekspertizës. AK Kuvendi Komunal Prishtinës është deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit

shqyrtues, ndërsa ankuesi “Kelmend Kastrati” nga Prishtina si dhe ankuesja “Anitë Sadikaj” nga Prishtina ka deklaruar se pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues.

*- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 10.03.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e ankueseve “Kelmend Kastrati” si dhe “Anitë Sadikaj” nga Prishtina të aprovohen, pjesërisht si të bazuar.

- të anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK-së të datës 17.01.2023, ndërkaq lënda të kthehet në rivlerësim me qëllim të trajtimit të barabartë të OE-ve dhe të kërkohen informata shtesë në pajtim me dispozitat e nenit 72 të LPP-së.

#### **Seanca dëgjimore-**

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrësit e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

#### Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues – “Kelmend Kastrati” nga Prishtina

##### Pretendimi nr.1

Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës nr.60/23 është se AK në kundërshtim me kërkesat e dosjes i ka rekomanduar për kontratë dy inxhinier të ndërtimit dhe një inxhinier të hidros, ndërsa kërkesa e dosjes ka qenë për një inxhinier të ndërtimit dhe dy inxhinier të hidros.

Pas analizimit të kërkesave të dosjes së tenderit, ofertave të kandidatëve dhe njoftimit mbi vendimin e AK-së, kemi gjetur se AK ka rekomanduar për kontratë dy inxhinier të ndërtimit edhe pse në dosje të tenderit kërkesa ka qenë vetëm për një inxhinier të tillë

Provë : Dosja e tenderit - 9.1&9.2

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<b>Kapaciteti teknik dhe profesional:</b> OE - personi fizik duhet të	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i> - Kopja e
---	-----------	--	--

<p>jene: -Te profileve të Inxhinierisë (Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës) se paku 5 vite përvojë pune.</p>	<p>Diplomës Universitare Master - CV-ja e nënshkruar nga vetë personi - Letër referencë mbi përvojën e punës</p>
<p>- Dy Arkitekt Master se paku 5 vite përvojë pune.</p>	<p>Referenca duhet të përmbajë të</p>
<p>- Një Inxh, i Ndërtimit të Lartë master se paku 5 vite përvojë pune.</p>	<p>dhënat e punëdhënësit siç janë (numri kontaktues dhe email</p>
<p>- Dy inxh. të Hidros Master se paku 5 vite përvojë pune.</p>	<p>adresa zyrtare) - Kopja e Certifikatës trajnuese për</p>
<p>- Të kenë referenca të përvojës së punës për menaxhim të projekteve në vlera prej se paku 500.000 euro</p>	<p>menaxhim të projekteve - Kopjen e Certifikatës për njohuri të Gjuhës Angleze B2 apo më lart ose referenca</p>
<p>Inxhinieri i ndërtimit të lartë dhe inxhinieri i hidros duhet të kenë shkathësi kompjuterike në programet</p>	<p>nga Kompanitë Internacionale që tregojnë se kandidati zotëron gjuhën angleze. Shënim Kandidati që ka më</p>

	<p>Word, Excel, autocad, MS Project (certifikata e preferueshme). ndërsa</p> <p>- inxhinieri arkitekturës duhet të kenë shkathtësi kompjuterike në programet archicad dhe autocad.</p> <p>- Të njoh Gjuhën Angleze në nivelin B2 apo më lart. Kandidatet që kanë referenca me të mira në projekte internacionale të tilla me shumë se të dëshirueshëm sepse kemi të bëjmë me Projekte të Bankës Botërore, BERXHI-n, Banka Evropiane për Investime etj. (të gjitha këto vlejné për të gjithë kandidatet që aplikojné).</p>	<p>shumë përvojë pune do të ketë prioritet me tepër se kandidatet tjerë)</p>	
<p>Bazuar në këto që u cekën më lart, mendimi ekspertit se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar, dhe se AK ka bërë shkelje të dosjes së tenderit në pikat e lartcekura.</p>			

### Pretendimi nr.2

pretendimi i dytë ankimor sipas ankesës nr.60/23 ka të bëjë me arsyetimin e AK-së se OE ankues nuk ka ofruar certifikatë për njohje të gjuhës angleze dhe certifikatë për PMP e njohur ndërkombëtarisht.

OE ankues pretendon se i njëjti i plotëson kërkesat e AK-së, megjithëkëtë i njëjti pretendon se AK në pajtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së ka mund të kërkoj plotësim të dokumenteve ose sqarim të dokumentacionit.

Mendimi i ekspertit është se AK në pajtim me nenin 72 të LPP-së ka mund të kërkoj sqarime dhe plotësim të dokumentacioni për dokumente ekzistenca e të cilave është e fiksuar para afatit për ofertim

Po ashtu sqarojmë se kërkesa për certifikatë të gjuhës angleze kërkesa decidive ka qenë: "Kopjen e Certifikatës për njohuri të Gjuhës Angleze B2 apo më lart ose referenca nga Kompanite Internacionale që tregon se kandidati zotëron gjuhën angleze. "Ndërsa për certifikatë të PMP kërkesa decidive ka qenë: "PMP apo ekuivalente - 10pikë"

Do thotë përveç PMP është lejuar edhe "ekuivalent" dhe në këto rrethana mendojmë se AK prape konform nenit 72 ka mund të kërkoj sqarim/plotësim shtesë.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pjesërisht i bazuar dhe rekomandojmë që gjatë rivlerësimit eventual AK të kërkoj sqarime shtesë në pajtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së.

### Pretendimi nr.3

Pretendimi i fundit ankimorë sipas ankesës 60/23 ka të bëjë me arsyetimin e AK-së se OE ankues nuk ka ofruar referenca në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit.

OE ankues pretendon se i njëjti i plotëson kërkesat e dosjes për referenca dhe pretendon se përmes ankesës në OSHP i ka bashkangjitur edhe sqarimin referencës të lëshuar nga kompania Postarch ku i njëjti pretendon se ka përfunduar projekte në vlerë mbi gjysmë milion euro.

Edhe në këtë rast mendimi ekspertit është se në pajtim me nenin 72 të LPP-së AK do duhej të kërkoj sqarime/plotësim shtesë me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike, njëjti siç ka vepruar me kandidat/OE të tjerë.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Sa i përket pretendimit OE ankues "Anitë Sadikaj" e cila pretendon se i njëjti i plotëson kërkesat e AK-së dhe se ka ofruar dëshmi ekuivalente, paneli shqyrtues, vlerëson se AK në pajtim me nenin 72 të LPP-së ka mund të kërkoj sqarime për dokumente ekzistenca e të cilave është e fiksuar para afatit për ofertim, pra bazuar në këto që u cekën më lart paneli vlerëson se pretendimi ankimorë është i bazuar obligohet që AK gjatë rivlerësimit eventual AK të kërkoj sqarime shtesë në pajtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së.

### Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues - Anitë Sadikaj nga Prishtina.

#### Pretendimi Nr.1

Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës 62/23 ka të bëjë me arsyetimin e AK-së se OE nuk ka ofruar certifikatën PMP, ku sipas OE ankues në rastin konkret përveç certifikatës PMP është lejuar edhe "ekuivalent". OE ankues pretendon se i njëjti i plotëson kërkesat e AK-së dhe se ka ofruar dëshmi ekuivalente. Mendimi i ekspertit është se AK në pajtim me nenin 72 të LPP-së ka mund të kërkoj sqarime për dokumente ekzistenca e të cilave është e fiksuar para afatit për ofertim.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar dhe rekomandojmë që gjatë rivlerësimit eventual AK të kërkoj sqarime shtesë në pajtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së.

#### Pretendimi Nr.2

Pretendimi i dytë ankimorë sipas ankesës nr.62/23 ka të bëjë me arsyetimin e AK-së se OE ankues nuk ka ofruar certifikatë shkathtësi të programeve kompjuterike si WORD etj. Në rastin konkret kërkesa "certifikatë" lidhur këto shkathtësi ka qenë e "dëshirueshme".

Pra ashtu siç pretendon OE ankues kriteri ka qenë që certifikata e preferueshme dhe se nuk ka ekzistuar kriter apo edhe nën kriter për vlerësim në formë poentimi dhe eliminimi i pikëve për këtë kriter është i pa pranueshme. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

### Pretendimi Nr.3

Pretendimi i fundit ankimorë sipas ankesës 60/23 ka të bëjë me arsyetimin e AK-së se OE ankues nuk ka ofruar referenca në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit.

OE ankues pretendon se i njëjti i plotëson kërkesat e dosjes për referenca dhe se AK për çdo paqartësi ka mund të kërkoj sqarime shtesë.

Edhe në këtë rast mendimi ekspertit është se në pajtim me nenin 72 të LPP-së AK do duhej të kërkoj sqarime/plotësim shtesë me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike, njëjtë siç ka vepruar me kandidat/OE të tjerë. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar

### **MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, në të njëjtën kohë rekomandojmë që lënda të kthehet në rivlerësim me qëllim të trajtimit të barabartë të OE-ve dhe të kërkohen informata shtesë në pajtim me dispozitat e nenit 72 të LPP-së.

**Paneli shqyrtues** pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli dhe si rrjedhojë paneli vendosi që ankesat e “Kelmend Kastrati” dhe “Anitë Sadikaj” nga Prishtina të aprovohen pjesërisht, ndërkaq AK obligohet që konfirmimit të ekspertit lëndën ta kthehej në rivlerësim me qëllim të trajtimit të barabartë të OE-ve dhe të kërkohen informata shtesë në pajtim me dispozitat e nenit 72 të LPP-së.

Si dhe pretendimin e parë ankimorë sipas ankesës nr.60/23 është se AK në kundërshtim me kërkesat e dosjes i ka rekomanduar për kontratë dy inxhinier të ndërtimit dhe një inxhinier të hidros, ndërsa kërkesa e dosjes ka qenë për një inxhinier të ndërtimit dhe dy inxhinier të hidros, PSH e klasifikon të bazuar.

*- Përfundim -*

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 dhe 60 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të

përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues  
Vedat Poterqoi



#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna e Prishtinës

1x1 OE-ve ankuese "Kelmend Kastrioti" dhe "Anitë Sadikaj" nga Prishtina

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.